

Përmbledhje mbi të rejat më të fundit

Njoftim mbi publikimin e Portalit Self-Care për Fiskalizimin

Me Vendimin Nr. 431, datë 03.06.2020 “Për platformën qendrore të faturave” janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) mbi lidhjen dhe paraqitjen e informacionit të lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në platformën qendrore të faturave elektronike.

Bazuar në këtë vendim, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të:

1. Lidhen dhe të regjistrohen në platformën qendrore të faturave.
2. Të sigurojnë ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve thelbësore për rolin e tyre, në një mënyrë të besueshme dhe profesionale, në përputhje me dokumentacionin dhe specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.
3. Të vënë në dispozicion të njëri-tjetrit informacionin përkatës që disponojnë.
4. Të respektojnë rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave, veçanërisht ato që mbrojnë të dhënat personale dhe përdorin procedurat dhe pajisjet e duhura teknologjike.

Aksesimi i platformës qendrore të faturave dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet AKSHI-t, lëshuesit dhe marrësit të faturave elektronike përmes platformës qendrore të faturave, do të jete përmes portalit Self-Care. “Portali Self-Care” është një faqe e standardizuar për

komunikim ndërmjet tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për transferimin elektronik të të dhënave nëpërmjet internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar të gjithë tatimpaguesit se tashmë në e-Albania është publikuar Portali SelfCare, në versionin Test dhe Live. Ju inkurajojmë që fillimisht, të përdorni këtë modul në versionin Test, me qëllim familjarizimin me funksionalitet e implementuara si dhe kryerjen e veprimeve testuese pa asnjë efekt në raportimin tatimor. Ndërkohë që në versionin Live do të mund të kryeni të gjitha veprimet e nevojshme për raportimet e fiskalizimit për të dhënat e njësisë së biznesit, operatorit, faturat e fiskalizuara, çeljen e arkës, etj.

Për të lexuar materialin e plotë, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/45/1446/njoftim-mbi-publikimin-e-portali-selfcare-per-fiskalizimin>

Miratohet Akti Normativ
Nr. 31, datë 7.10.2020

Këshilli i Ministrave në Aktin Normativ Nr. 31, datë 7.10.2020 vendosi:

1. Të falen të gjitha masat administrative me karakter ndëshkues, të vendosura nga autoritetet shtetërore përkatëse, për shkeljen e rregullave apo të akteve ligjore e nënligjore të nxjerra në kuadër të masave të ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, nga data 17.4.2020 deri në datën 7.10.2020.
2. Të falen të gjitha masat administrative të vendosura nga strukturat e njësive të vetëqeverisjes vendore ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, tërmetet e datave 21 shtator dhe 26 nëntor 2019, për shkeljet e konstatuara gjatë kryerjes së punimeve për riparimin/rindërtimin e banesave individuale.



3. Të kthejë shumën e detyrimit të falur, por të paguar, për masat administrative me gjobë brenda datës 15 nëntor 2020.
4. Të kthejë lejet/licencat dhe i mjetet e bllokuara, në zbatim të masave administrative brenda datës 15 nëntor 2020 te subjekti përfitues.

Akt normativ nr. 32, datë 12.10.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave Vendosi që duke filluar nga data 15 Tetor 2020 mbajtja e Barrierës mbrojtëse (maska) të bëhet e detyrueshme kudo në ambientet jashtë shtëpisë nga çdo individ.

Mospërdorimi i barrierës mbrojtëse (maskës) nga individët jashtë shtëpisë dënohet me gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë. Të drejtën e dhënies së masës administrative për mospërdorimin e barrierës mbrojtëse (maskës) e ka Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake, sipas modelit të gjobës të miratuar prej tyre. Ekzekutimi i masës administrative do të kryhet nëpërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, duke u bërë pjesë e faturave të energjisë elektrike.

Drejtoresha e Institutit të Shëndetit Publik, znj. Albana Fico, ka bërë të ditur se është miratuar “Udhëzuesi mbi përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambientet jashtë shtëpisë”, që paraqet kriteret e përgjithshme, rregullat dhe përjashtimet për përdorimin e barrierave mbrojtëse (maskave) në ambientet jashtë shtëpisë, me qëllim zvogëlimin e përhapjes së mundshme të COVID-19.

Sipas udhëzuesit çdo individ mbi moshën 11 vjeç duhet të vendos maskë në ambientet jashtë shtëpisë:

1. Gjatë të gjithë ditës gjatë të gjithë veprimtarisë jashtë banesës.
2. Në çdo dyqan, supermarket apo aktivitet tregtar.
3. Në të gjitha mjetet e transportit publik dhe jo publik kur në to gjenden persona të tjerë përveç drejtuesit të automjetit.
4. Gjatë ecjes në rrugë.
5. Gjatë qëndrimit në të gjitha vendet publike të hapura si park apo shesh.
6. Gjatë të gjithë aktivitetit të punës në zyra, të gjithë institucionet publike dhe jo publike, teatër, kinema, muze, biblioteka, etj
7. Në hyrje dhe dalje nga banesa si dhe ashensorë.
8. Përpara dhe pas konsumit të ushqimit në bare dhe restorante.
9. Në motoçikletë kur merr një person tjetër jo anëtarë të familjes.
10. Nëse jeni duke u kujdesur në shtëpi për një familjar me COVID19.
11. Në të gjitha institucionet fetare.
12. Nga personat që e kanë kaluar SARS COV -2 për t'u mbrojtur nga shkatarrët e tjerë infektivë respiratorë.
13. Në institucionet arsimore dhe ato të kujdesit shëndetësor sipas rekomandimeve të mëparshme.

Vendosja e barrierës mbrojtëse (maskës) nuk mund të jetë e mundur në çdo situatë. Prandaj, ka disa raste kur ju lejohe të hiqni atë apo të modifikoni përdorimin e saj.

1. Nëse kërkohet për qëllime të identifikimit personal nga zyrtarët përkatës në polici, në bankë, postë, gjykatë, etj

2. Gjatë ngrënies apo konsumimit të pijeve por në hyrje e në dalje nga baret dhe restorantet maska duhet të vendoset.
3. Gjatë procesit të manipulimeve dentare por në hyrje e në dalje nga klinika maska duhet të vendoset.
4. Nga personat që mbajnë/drejtojnë lutjen /shërbesën/ ceremoninë fetare
5. Nga persona me humbje të dëgjimit dhe të folurit ose për personat gjatë kohës së komunikimit me ta, nëse nuk kanë mundësi të përdorin maska të posaçme (transparente).
6. Nëse kërkohet nga stafi i dyqaneve ose marketeve përkatëse për identifikim të moshës, përfshirë blerjen e produkteve me moshë të kufizuar, siç janë duhani dhe alkooli
7. Nga punëtorët që punojnë në ambiente të jashtme, gjatë procesit të punës kur sigurohet distance fizike jo më pak se 1.5m.
8. Nga të ftuarit në emisionet televizive me kusht që të ruhet distanca jo më pak se 1.5 metra.

Udhëzuesi i miratuar përcakton qartë rastet përjashtimore të përdorimit të maskës:

1. Në të gjitha rastet kur përdorimi i maskës dëmton shëndetin sipas rekomandimit të mjekut të familjes.
2. Nga persona me sëmundje që i bëjnë të paaftë për përdorimin maskës.
3. Gjatë ushtrimit të aktiviteteve sportive.
4. Nga persona të cilët lëvizin të vetëm me biçikletë, motoçikletë apo monopatinë.
5. Kur në makinë është vetëm drejtuesi i mjetit ose persona që kanë lidhje familjare me të

6. Në aktivitete që mund të shkaktojnë lagjen e maskës, si p.sh. gjatë larjes në pishinë, liqen ose në det.
7. Në shtëpi me anëtarët e ngushtë të familjes.

Për të lexuar Udhëzuesin mbi përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambientet jashtë shtëpisë, klikoni në linkun më poshtë:

<http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/1163-1UDHEZUES-MBI-PERDORIMIN-E-DEYRUESHEM-TE-MASKAV-NE-AMBJENTET-SHTEPIAKE-1.pdf>